



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3681/ 13 prot.

Datë 21/01/2025

V E N D I M
Nr. 93/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 21/01/2025, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 19/2025, datë 07.01.2025 për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-23013-10-07-2024, me objekt “Supervizion punimesh Ndërtim aksi rrugor Elbasan - Paperr Faza II”, me fond limit 18,230,373.81 (tetëmbëdhjetë milion e dyqind e tridhjetë mijë e treqind e shtatëdhjetë e tre presje tetëdhjetë e një) leke pa TVSH ose 184,405.96 (njëqind e tetëdhjetë e katër mijë e katërqind e pesë presje nëntëdhjetë e gjashhtë) euro pa TVSH, zhvilluar me datë 08.11.2024 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Ankimues: Operatori ekonomik “M.A.K Studio” SHPK me NIPT L014220170, me adresë: *Njësia Bashkiake Nr. 7, Rruga “Muhedin Llagani”, Pallat 12- katësh (VALA), Kati 1, Nr. 7 Tiranë.*

Autoriteti Kontraktor: Autoriteti Rrugor Shqiptar
Adresa: “Rruga Sami Frashëri nr.33”, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe

Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 07.01.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 19/2025, ku vendosi:

- 1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “M.A.K Studio” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-23013-10-07-2024, me objekt “Supervizion punimesh Ndërtim aksi rrugor Elbasan - Paperr Faza II”, me fond limit 18,230,373.81 (tetëmbëdhjetë milion e dyqind e tridhjetë mijë e treqind e shtatëdhjetë e tre presje tetëdhjetë e një) leke pa TVSH ose 184,405.96 (njëqind e tetëdhjetë e katër mijë e katërqind e pesë presje nëntëdhjetë e gjashtë) euro pa TVSH, zhvilluar me datë 08.11.2024 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.*
- 2. Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik “M.A.K Studio” SHPK, të korrigjojë shkeljet e konstatuara, si dhe të kryejë veprimet procedurale në lidhje më zbatimin e konstatimeve të më sipërme.*
- 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
- 4. Ngarkohet zyra e financës, të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “M.A.K Studio” SHPK.*
- 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
- 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 426/1 prot., datë 15.01.2025, protokolluar me tonën nr. 3681/10 prot., datë 20.01.2025, autoriteti kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar informoi lidhur me zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 19/2025, datë 07.01.2025, duke e rivlerësuar ofertën e operatorin ekonomik “M.A.K Studio” Sh.P.K në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-23013-10-07-2024, me objekt “Supervizion punimesh

Ndërtim aksi rrugor Elbasan - Paperr Faza II”, me fond limit 18,230,373.81 (tetëmbëdhjetë milion e dyqind e tridhjetë mijë e treqind e shtatëdhjetë e tre presje tetëdhjetë e një) leke pa TVSH ose 184,405.96 (njëqind e tetëdhjetë e katër mijë e katërqind e pesë presje nëntëdhjetë e gjashtë) euro pa TVSH, zhvilluar me datë 08.11.2024 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 426/1 prot., datë 15.01.2025, protokolluar me tonën nr. 3681/10 prot., datë 20.01.2025, autoriteti kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar informoi lidhur me zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 19/2025, datë 07.01.2025, duke e rivlerësuar ofertën e operatorin ekonomik “M.A.K Studio” Sh.P.K në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-23013-10-07-2024, me objekt “Supervizion punimesh Ndërtim aksi rrugor Elbasan - Paperr Faza II”, me fond limit 18,230,373.81 (tetëmbëdhjetë milion e dyqind e tridhjetë mijë e treqind e shtatëdhjetë e tre presje tetëdhjetë e një) leke pa TVSH ose 184,405.96 (njëqind e tetëdhjetë e katër mijë e katërqind e pesë presje nëntëdhjetë e gjashtë) euro pa TVSH, zhvilluar me datë 08.11.2024 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe verifikimeve të kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike shtojcës së publikuar në SPE, Komisioni vëren se, autoriteti kontraktor ka rivlerësuar procedurën e prokurimit në përputhje të plotë me përcaktimet e vendimit Nr. 19/2025, datë 07.01.2025.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-23013-10-07-2024, me objekt “Supervizion punimesh Ndërtim aksi rrugor Elbasan - Paperr Faza II”, me fond limit 18,230,373.81 (tetëmbëdhjetë milion e dyqind e tridhjetë mijë e treqind e shtatëdhjetë e tre presje tetëdhjetë e një) leke pa TVSH ose 184,405.96 (njëqind e

tetëdhjetë e katër mijë e katërqind e pesë presje nëntëdhjetë e gjashtë) euro pa TVSH, zhvilluar me datë 08.11.2024 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri

